

# E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Fokusi i muajit

### Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Figura e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit është një element kyç në zbatimin efektiv të ligjit për të drejtën e informimit.

Kjo figurë profesionale hyri në fuqi për herë të parë në vitin 2014 me miratimin e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Ligji përcakton se titullari i çdo institucioni cakton një prej nëpunësve në rolin e koordinatorit. Ky i fundit ka për detyrë ti mundësojë çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik. Gjithashtu koordinatori për të drejtën e informimit krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Koordinatori mban përgjegjësi për të gjitha elementet që kanë të bëjnë me kërkesat (regjistrimi, dërgimi, njoftimet paraprake, sigurimi i informacionit, etj.), komunikimin me kërkuar, llogaritjen e kostove dhe publikimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Shtrirja e madhe e përgjegjësisë së Koordinatorit dhe fakti që është ai që përballet me sanksione administrative të larta, ndërkohë që nuk ka kontroll të plotë mbi procesin, tregon për pozitën e vështirë në të cilën ndodhet Koordinatori për zbatimin e ligjit. Zyra e Komisionerit e ka adresuar disa herë çështjen e shtrirjes së përgjegjësisë së refuzimit të dhënies së informacionit, tek nëpunësi përgjegjës i cili bëhet pengesë për mosdhënien e informacionit, duke e shtrirë këtë qasje edhe në vendimarrjen e tij. Përpos këtyre vështirësive, autoritetet publike duhet të ndërgjegjësohen që forcimi i rolit të koordinatorit ndihmon në rritjen e transparencës institucionale dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.

## Përmbledhje mujore e vendimeve

### Vendim nr. 20

Informacioni mbi mbetjet urbane përbën informacion publik

### Vendim nr. 21

Vendimarrja e çdo autoriteti publik përbën informacion publik

### Vendim nr. 22

Kontrata e shërbimit me palë të treta përbën informacion publik

### Vendim nr. 23

Procedurat e prokurimit nuk mund të klasifikohen si "sekret bankar"

### Vendim nr.33

CV e atyre që ushtrojnë funksione publike përbën informacion publik

# Vendimarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

#transparencë #publikim #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit qershor, ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI). Të gjitha vendimet kanë qenë vendime urdhërimi ndaj autoriteteve publike për të dhënë informacionin e kërkuar.

KDIMDP gjatë shqyrtimit të ankesave të qytetarëve dhe ndjekjes së procedurave administrative sipas kompetencave të parashikuara nga LDI dhe ligji nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar (LMDHP), ka vërejtur se në raste të caktuara autoritetet publike përdorin argumente ligjore jo të qënësishme për të refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar. Zyra e Komisionerit në vendimarrjen e saj argumenton se LDI ka të përcaktuar qartë në nenin 17 të tij, të gjitha rastet e kufizimit të informacionit publik dhe vetëm rastet e parashikuara në këtë nen mund të jenë objekt i kufizimit të informacionit të kërkuar.

Autoritetet publike duhet të mbajnë parasysh se parimi i përgjithshëm i transparencës shpreh se çdo informacion i cili i shërben interesit publik dhe që disponohet nga autoriteti publik duhet të jetë publik.

Me anë të Vendimit nr. 21 datë 10.07.2020 Zyra e Komisionerit ka pranuar ankesën e Qendrës ResPublica e cila i kërkonte "Komisionit të Pavarur të Kualifikimit" (Autoriteti Publik) t'i vendoste në dispozicion Vendimin e Ndërmjetëm nr. 33 datë 27.05.2019 ndaj subjektit të rivlerësimit znj. Hajrie Muçmata si dhe kopje të Vendimit datë 29.10.2019 "Për rrëzimin e kërkesës së subjektit për përjashtimin e trupit gjykues". Autoriteti Publik fillimisht e refuzoi dhënien e informacionit me pretendimin se nuk dispononte një vendim të tillë për sa kohë në kërkesë ishte bërë një gabim material për mbiemrin e subjektit të



rivlerësimit nga Muçmata në Muçmataj. Pasi kërkuesi e korrigjoi gabimin material dhe paraqiti për herë të dytë kërkesën, ajo u refuzua përsëri.

Kësaj here kërkesa u refuzua me argumentin se sipas ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" është detyrim i anëtarëve të institucionit të rivlerësimit dhe personelit të tyre të trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, dhe me argumentin tjetër se arsyetimi i vendimit datë 29.10.2019 është publikuar në faqen zyrtare të KPK, duke bërë publik vetëm informacionin që gjendet në vendimin e themelit, pasi vlerësimi i tij bëhet rast pas rasti, dhe publikimi i tij mbetet në vlerësimin e Komisionit.

KDIMDP pasi shqyrtoi ankesën e Qendrës ResPublica si dhe duke mbajtur në konsideratë përgjigjen e autoritetit publik, në përfundim të procedurës së shqyrtimit administrativ të çështjes, vlerësoi se pretendimet e paraqitura nga autoriteti publik janë të pabazuara në ligj dhe në prova.

KDIMPD argumentoi se parimi i konfidencialitetit nuk ka për qëllim të rregullojë kufizimin e publikimit të informacionit, por të normojë sjelljen e nëpunësve të administratës publike të cilët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre vihen në dijeni të të dhënave personale të subjekteve të tjerë. Për më tepër që nga një analizë e gjithë kuadrit ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit në sistemin e drejtësisë (lexo vendimin nr. 21 datë 10.07.2020) reflektohet qartë mbizotërimi i interesit publik në raport me interesat e subjekteve të rivlerësimit. Për më shumë, në pikën 7 të nenit nr. 4 të ligjit 84/2016 të sipërcituar, parashikohet shprehimisht se "E drejta e informimit (...) mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.

Në përfundim KDIMDP vlerësoi se ndryshe nga sa pretendon autoriteti publik, ky përkuzim nuk mund të aplikohet për informacionin e kërkuar, pasi objekti i kërkesës ka të bëjë me aktin administrativ që përkon me vendimarrjen e autoritetit publik dhe jo me procesin e rivlerësimit në vetvete.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al)


# REKOMANDIM PËR AGJENCINË SHTETËRORE TË MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson dhe mbështet maksimalisht të gjitha përpjekjet për të ndërgjegjësuar aktorët publikë, për të dhënë kontributin e tyre në mbrojtjen e fëmijëve vecanërisht ata që gjendet në situatë emergjente. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, brenda kompetencave që i nje ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligji nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" ka nisur punën për identifikimin e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave me qëllim monitorimin dhe nxitjen e tyre për publikimin proaktiv të të gjithë këtij informacioni.

Gjatë muajit korrik, Zyra e Komisionerit monitoroi publikimin e informacionit në programin e transparencës në faqen zyrtare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Pas përfundimit të monitorimit, Zyra e Komisionerit miratoi Rekomandimin nr. 16 datë 22.07.2020 "Për rishikimin/përditësimin e Programit të Transparencës të Autoritetit Publik/Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve".

Zyra e Komisionerit vlerëson se publikimi proaktiv dhe lehtësisht i aksesueshëm i informacionit të plotë lidhur me politikat, planet, masat, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse, shërbimet rreth fëmijës dhe familjes, mund të vijë në ndihmë për parandalimin, identifikimin e hershën, si dhe trajtimin sa më efektiv të situatave të emergjencës në të cilat mund të ndodhen ata.

Për më shumë mund të lexoni të plotë rekomandimin në këtë link [https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/07/Rekomandim\\_nr\\_16\\_ASHMDF.pdf](https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/07/Rekomandim_nr_16_ASHMDF.pdf)



*Për të lexuar newsletter-in mujor në adresën tuaj të email-it mjafton të regjistroheni në adresën [info@idp.al](mailto:info@idp.al)*

# Rishikimi i Programit të Transparencës

## MODELI I RI I PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

### PROGRAMI I TRANSPARENCËS

#### Hyrje

Rreth autoritetit	Kuadri ligjor rregullator	E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanizmat kontrollues, monitorues dhe raportet lidhur me veprimtarinë institucionale	Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të autoritetit publik	Informacion për procedurat e prokurimit / procedurat konkurruese të koncesionit / partneritetit publik privat
Shërbimet që ofrohen	Vendimmarrja, procedura e ankimit, procedurat / mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me akte ligjore / nënligjore apo në lidhje me funksionet e autoritetit	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Ndihma shoqërore / subvencioneve të dhëna nga autoriteti	Informacione / dokumente që kërkohen shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka hartuar modelin e ri të programit të transparencës i cili do të zbatohet nga autoritetet publike qendrore, institucionet e varësisë dhe autoritetet e pavarura. Një program transparence specifik për njësitë e qeverisjes vendore është tashmë në fuqi që prej datës 01.01.2019. Modeli i ri i programit të transparencës specifikon për çdo kategori të caktuar informacioni, dokumentacionin konkret që do të publikohet në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014. Njëkohësisht, është rinovuar edhe paraqitja grafike për ta bërë akoma edhe më të lehtë dhe proaktiv përdorimin e tij nga qytetarët.

Drafti i programit të transparencës u publikua në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit për konsultim dhe komente / sugjerime si dhe u dërgua elektronikisht në drejtim të organizatave të shoqërisë civile dhe koordinatorëve për të drejtën e informimit. Zyra e Komisionerit ka administruar disa komente dhe sugjerime, të cilat do të rishikohen në ditët në vijim, në mënyrë që të pasqyrohen nëse është e mundur, në programin e ri të transparencës. Zyra e Komisionerit vlerëson të aprovojë modelin e ri të programit të transparencës dhe botimin në fletoren zyrtare në Shtator 2020.

# Plani i veprimit i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2020-2023

## STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

2015-2023

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 516 datë 01.07.2020 miratoi Planin e Veprimit 2020-2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023. Në këtë plan veprimi, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përgjegjëse për realizimin e Objektivit A1: *Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion*. Konkretisht ky objektivi do të realizohet gjatë periudhës 2020-2023 nëpërmjet krijimit të 2 sistemeve të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek autoritetet publike qendrore, varësisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe nëpërmjet instalimit të regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrit nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit gjen rastin të ftojë të gjitha organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë me mbështetje për realizimin e Objektivit "Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion" pjesë e planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2020 - 2023.

Për më shumë lexoni të plotë V.K.M nr.516 datë 01.07.2020 dhe Planin e Veprimit 2020-2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023 në link-un <http://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektorale->

*Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale fton të gjitha organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë me mbështetje në realizimin e Objektivit "Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion" pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2020 -2023*

